

URDHËR
Nr.6386/1, datë 7.10.2011

PËR HEQJEN E LEJES SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 1 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 6 germa “dh” të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

KONSTATOJ:

Se, me vendimin penal nr.437, datë 2.12.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit Ylli Mehmeti për kryerjen e veprës penale “Falsifikim të dokumentit bërë nga personi që e ka për detyrë lëshimin e tyre”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit të Procedurës Penale dhe dënimin e tij me 300 000 lekë gjobë. Bazuar në nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale, Ylli Mehmeti, me detyrë noter, përfundimisht është dënuar me 200 000 lekë gjobë. Ky vendim merr formë të prerë me vendimin nr.67, datë 9.2.2011 të Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila ka vendosur mospranim të ankimit. Prokurori ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit nr.437, datë 2.12.2009.

Për këto arsye:

Bazuar në nenin 6 germa “dh” të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit z.Ylli Mehmeti, anëtar i Dhomës së Noterisë Vlorë.

2. Ngritjen e komisionit të dorëzimit të arkivit të përbërë nga 5 anëtarë.

a) Z.Arlind Arapi, përgjegjës i sektorit të inspektimit për zbatimin e drejtësisë.

b) Znj.Aleksandra Tasi, specialiste në zyrën e mbajtjes së regjistrit të noterëve.

c) Znj.Mirela Llaperi, arkiviste në zyrën e mbajtjes së regjistrit të noterëve.

d) Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Vlorë.

e) Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.

3. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Vlorë. Arkivi do t’i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 3-mujor, një noteri publik të Dhomës së Noterisë Vlorë që plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivës dhe që kryen një shërbim sa më të shpejtë e cilësor të të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.

4. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noterit z.Ylli Mehmeti nga komisioni i caktuar në pikën 2 të këtij urdhri.

5. Urdhri t’u njoftohet menjëherë ministrive, Dhomës Kombëtare të Noterisë, gjykatave të shkallës së parë dhe apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Prokurorisë së Përgjithshme dhe institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Ngarkohet sektori i inspektimit për zbatimin e drejtësisë dhe zyra e mbajtjes së regjistrit të noterëve të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi